REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQESISE PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 2925
Nr. I fq./Br. Str./No. pg. 2+1
Data/Datum/Date: 19.10.2026
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

---

Datë: 19.10.2026
Ref. KM335/2026

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK)-Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, (21.06.2024), duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) – Nr.08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive (14.10.2026), në bazë të nenit 8, (paragrafi 8.2), të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, (Gazeta Zyrtare, Nr. 8, 01 janar 2007), nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MA - NR. 11/2007 për Sezonin e Gjuetisë (datë 14 shtator 2007), Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr.12/2020 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura të dt.15.12.2020, si dhe nenet 2, 3, 4, 6 dhe 11, të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr. 02/2008 Për përdorimin e armëve dhe municionit të përshtatshëm për gjueti (datë 03 mars 2008), si dhe Rekomandimit të U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR-së, të datës 14.10.2026, i cili mbështetet në Raportin Analitik mbi arsyeshmërinë e hapjes së sezonit të gjuetisë, të përgatitur nga Departamenti Qendror i Inspekcionit për Pylltari dhe Gjueti, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr:

V E N D I M
PËR HAPJEN E SEZONIT TË GJUETISË 2026 - 2027

1. Shpallet i hapur sezoni i gjuetisë për periudhën 2026 - 2027 për lloje të caktuara të kafshëve të egra.

2. Sezoni i gjuetisë shpallet i hapur nga data 25.10.2026 **(E Diel, 25 Tetor 2026).**

3. Gjuetia do të zhvillohet në reduktimin (zvogëlimin) e llojeve të caktuara të kafshëve dhe shpezëve të egra, sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, dhe në harmoni me planet vjetore te menaxhimit me vend gjueti të aprovuara sipas legjislacionit ne fuqi.

4. Aktivitetet e gjuetisë, mundë ti organizojnë vetëm menaxherët e vendgjuetive të cilët kanë të hartuar dhe aprovuara planin dhjetë vjeçare (10) të menaxhimit të vend gjuetisë sipas nenit 42 dhe planin vjetor të menaxhimit të vend gjuetisë sipas nenit 43 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2008, Për përmbajtjen, mënyrën e hartimit dhe procedurat e aprovimit të planeve të menaxhimit në vend gjueti të dt. 21.03.2008.

5. Vendgjuetitë te cilat kanë të aprovuar planet vjetore të menaxhimit 2026 - 2027 janë të listuara në shtojcën e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

6. Gjahtarët mund të marrin pjesë në gjueti, nëse kanë të dhënë provimin për gjahtarë sipas nenit 11 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë - Kualifikimi i gjahtarëve dhe vlerësuesve të Trofeve, dhe sipas kritereve të Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2007, Programi për aftësimin e kuadrove në gjueti (datë 14.09.2007), si dhe të ketë lejen me shkrim nga menaxheri i vend gjuetisë.

7. Menaxherët e vendgjetive janë të obliguar që të evidentojnë dhe raportojnë për çdo kafshe te gjuajtur dhe çdo dyshim për sëmundje ngjitëse eventuale.

8. Gjuetia do të organizohet vetëm gjatë ditëve të **diela** dhe në ditët festave zyrtare sipas Ligjit Nr.03/L - 064 Për Festat Zyrtare në Republikën re Kosovës.

9. Organizimi i gjuetisë në bazë të këtij Vendimi bëhet nga menaxherët e vendgjuetive, nën mbikëqyrjen e organeve përgjegjëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Departamentit Qendror të Inspekcionit për Pylltari dhe Gjueti, si dhe të komunës përkatëse në territorin e së cilës zhvillohet aktiviteti i gjuetisë.

10. Gjuetia e kafshëve të egra duhet të bëhet në përputhshmëri të plotë me nenin 5, 8, 9 , 10 , 11 dhe 14 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MA – Nr. 11/2007, Për Sezonin e Gjuetisë si dhe në harmoni me Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr.12/2020 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura të dt.15.12.2020 si dhe duke respektuar kalendarin e gjuetisë për secilin lloj të kafshëve të egra.

11. Për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij Vendimi obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Departamenti Qendror i Inspekcionit për Pylltari dhe Gjueti, si mekanizmi kompetent i Ministrisë për inspektimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Vendimi, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e pylltarisë dhe gjuetisë.

12. Vendimi do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Ueb faqen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe në media të shkruara sipas legjislacionit në fuqi.

13. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Armend MUJA

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Vendimi iu dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së U.d. Sekretarit të Përgjithshëm*
- *Departamenti Qendror i Inspekcionit për Pylltari dhe Gjueti (DQIPGJ);*
- *Agjencisë së Pyjeve të Kosovës;*
- *Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës (Drejtorive Rajonale dhe Njësive Komunale të Policisë);*
- *Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;*
- *Drejtorive komunale kompetente për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;*
- *Federatës së Gjahtarëve të Kosovës;*
- *Menaxherëve të vendgjuetive;*
- *KFOR-it;*
- *EULEX-i, dhe*
- *Arkivit.*

Lista e vendgjuetive te përbashkëta qe plotësojnë kriteret ligjore për te organizuar gjuetinë ne sezonin 2026-2027

Nr	Komuna	Vendgjuetia
		Emërtimi I VGJ
N		
1	Fushë Kosovë	1. Bjeshka
2	Suharekë	2. Gallusha
3	Pejë	3. Duboçaku
		4. Podguri
4	Lipjan	5. Lipjani lindje
		6. Lipjan Perëndim
5	Gjilan	7. Maja e gjelbër
		8. Karadaku
		9. Zhegoci
6	Graçanicë	10.Gracanica
7	Dragash	11.Sharri-Sar
8	Ferizaj	12.Ferizaj
9	Mitrovica e Jug	13.Shala
10	Obiliq	14.Qiqavica
11	Hani I Elezit	15.Kroni i Ftoftë
12	Deçan	16.Lojza
13	Shtërpcë	17.Canus Lupus
14	Vushtrri	18.Shala
		19.Qyqavica
15	Kaçanik	20.Lybeteni
16	Istog	21.Mokna
17	Prishtinë	22.Prishtina I
		23.Prishtina II
		24.Prishtina III
18	Skenderaj	25.Drenica
19	Ranillug	26.Kriva Reka

Sipas evidences zyrtare të Departamentit te Pylltarise

Prishtine 08 10 2026

Perpiloi; Naser Krasniqi, shef I Div. MKE

Vertetoi; T. Ahmeti , Drejtor I DP